



Бр/Нр. \_\_\_\_\_  
Скопје/Shkup \_\_\_\_\_ година/viti

Në bazë të nenit 27 të Statutit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore dhe sipas Vendimit për mënyrën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.214/21), drejtori i Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, miraton

## UDHËZIMIN

për mënyrën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore

### Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

Me këtë udhëzim përcaktohen kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, ruajtjes dhe përcjelljes së rregullshmërisë teknike të automjeteve zyrtare, evidentimin e automjeteve zyrtare, dëmtimin ose vjedhjen e automjeteve zyrtare dhe vërtetohet dokumentacioni i domosdoshëm që përdoret gjatë kryerjes së aktiviteteve.

#### Neni 2

Dispozitat e këtij udhëzimi kanë të bëjnë me të gjithë personat që drejtojnë automjete zyrtare.

Automjet zyrtar në kuptim të këtij udhëzimi është çdo automjet që është në pronësi të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

Automjet zyrtar motorik mund të shfrytëzojë i punësuar ose person i angazhuar në punë të përkohshme në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore, që posedon leje valide të vozitjes.

#### Neni 3

Përdorimi i automjetit patjetër duhet të jetë i miratuar, i arsyetuar, me qëllim dhe të jetë racional si dhe të jetë në pajtim me synimet e fushëveprimit të punës së ndërmarrjes publike (nevoja zyrtare). Automjetet zyrtare përdoren me kujdes.

### Kushtet dhe mënyra e përdorimit të automjeteve zyrtare

#### Neni 4

Automjetet zyrtare përdoren ekskluzivisht për kryerjen e kompetencave në Ndërmarrjen Publike të Rrugëve Shtetërore. Automjetet zyrtare nuk mund të përdoren për shkuarja dhe kthim nga puna ose për nevoja të tjera private.





#### Neni 5

Për përdorimin e automjetit zyrtar, përdoruesi duhet të ketë fletë mujore të udhëtimit (Shtojca nr.1)

#### Neni 6

Pas përfundimit të nevojës për përdorimin e automjetit zyrtar, përdoruesi e mbyll urdhërpagesën duke i plotësuar të dhënat për orën e kthimit, gjendjen dhe numrin e kilometrave të kaluar dhe ia dorëzon personit përgjegjës për autoparkun bashkë me çelësin e automjetit.

#### Neni 7

Automjeti zyrtar për udhëtim zyrtar përdoret nëse përdoruesi ka fletë udhëtimi për udhëzim zyrtar (ku shënohet nevoja, data, ora e nisjes). (Shtojca nr.2)

#### Neni 8

Përdoruesi gjatë kthimit të automjetit i paraqet defektet e mundshme mekanike dhe defektet e tjera, nëse kanë ndodhur gjatë përdorimit nga personi përgjegjës i autoparkut.

#### Neni 9

Nëse përdoruesi kthehet nga udhëtimi zyrtar pas përfundimit të orarit të punës, për këtë e informon udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë dhe personin përgjegjës të autoparkut.

#### Neni 10

Përdorimin e automjetit zyrtar pas përfundimit të orarit të punës, e miraton drejtori.

#### Neni 11

Mbushjen e automjetit zyrtar me benzinë e bën përdoruesi i automjetit, pas nevojës së konstatuar paraprakisht për këtë, ku llogarinë fiskale bashkë me vërtetimin e llogarisë, ia dorëzon personit përgjegjës të autoparkut.

### **Ruajtja dhe përcjellja e rregullshmërisë së automjeteve zyrtare**

#### Neni 12

Përdoruesi i automjetit zyrtar e parkon automjetin në parkingun e dedikuar për automjetet e ndërmarrjes publike, pas përfundimit të nevojës zyrtare.

#### Neni 13

Për përcjelljen e rregullshmërisë teknike të automjetit obligohet personi përgjegjës i autoparkut.

Çdo muaj personi përgjegjës i autoparkut bën kontroll vizual të automjeteve, ku përdor Listën për kontrollin e automjetit (Shtojca nr.3).





#### Neni 14

Nëse konstatohet ndonjë problem i automjetit, të njëjtin personi përgjegjës i autoparkut e dërgon te servisi i autorizuar përkatësisht te furnizuesi i jashtëm me të cilin Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore ka lidhur marrëveshje për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve.

#### Neni 15

Personi përgjegjës i autoparkut obligohet më së voni 10 ditë para dhe 10 ditë pas përfundimit të periudhës për mbajtjen e pajisjes dimërore (15.11-15.03), të organizojë ndryshimin e pajisjes së automjeteve nga regjimi veror në atë dimëror dhe anasjelltas.

#### Neni 16

Çdo automjet duhet të ketë higjienë të rregullt. Çdo automjet duhet të lahet, të paktën njëherë në muaj ose më shpesh varësisht nga gjendja, për çka obligohet personi përgjegjës i autoparkut.

### **Evidentimi i automjeteve zyrtare**

#### Neni 17

Personi përgjegjës i autoparkut mban Listë për serviset e rregullta (Shtojca nr.4) ku mban evidencë për serviset e realizuara periodike dhe serviset e planifikuara të radhës. Nga çdo servis i rregullt, të dhënat i evidenton në letrën e servisit (Shtojca nr.5).

#### Neni 18

Nëse automjeti ka nevojë për servis të jashtëzakonshëm- defekt, dëmtime e kështu me radhë, personi përgjegjës i autoparkut i dërgon automjetet në servis (i zgjedhur në furnizim publik) ndërsa pas riparimit mban evidencë për të dhënat e servisit të jashtëzakonshëm në letrën amë të automjetit (Shtojca nr.6). Personi përgjegjës i autoparkut obligohet që në letrën amë për çdo automjet të vendos kopje të faturës për pjesët e ndërruara në automjet.

Nëse servisi nuk është në pajtim me kërkesën e vet, atëherë paraqitet nëpërmjet reklamacionit.

#### Neni 19

Personi përgjegjës i autoparkut bën planifikimin e regjistrimit të automjetit në Planin për regjistrimin e automjetit (Shtojca nr.7) dhe sipas kësaj bën organizimin e regjistrimeve. Automjetet i dërgon për regjistrim me autorizim të dhënë nga drejtori.

### **Dëmtimi ose vjedhja e automjetit zyrtar**

#### Neni 20

Nëse gjatë përdorimit të automjetit zyrtar ndodh dëmtimi i tij, përdoruesi i automjetit e informon personin e ngarkuar për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare dhe obligohet të bëj procesverbal europian ose të kërkoj ndihmë nga organi përkatës për përgatitjen e procesverbalit.





Nëse gjatë përdorimit të automjetit zyrtar ndodh vjedhje, përdoruesi menjëherë e informon personin e ngarkuar për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare dhe njëkohësisht e paraqet vjedhjen në stacionin më të afërt policor.

### Dispozita përmbyllëse

Neni 21

Udhëzimi hyn në fuqi nga dita e miratimit ndërsa do të publikohet në faqen e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore.

Ejup Rustemi

Drejtor,

